

AGJENTË

Kush mund të jetë agjent?

Një agjent mund të jetë një person i punësuar në një kompani pensionale, ose një person i cili është i punësuar me kontratë në një kompani pensionale, i cili ka dhënë provimin për agjentë në Agjencia për Mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional dhe i cili është i regjistruar në Regjistrin e Agjentëve.

Në regjistrin e agjentëve mund të jetë një person që plotëson kushtet e mëposhtme:

- ✓ Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë, ose, nëse është i huaj, të ketë status të rregulluar të të huaji në përputhje me ligjin;
- ✓ Të mos ketë asnjë sanksion gjyqësor për ndalimin e kryerjes së profesionit, aktivitet ose detyrë në fushat e ekonomisë, financave, sigurimeve, aktiviteteve bankare dhe ligjit;
- ✓ Të ketë përfunduar të paktën arsimin e mesëm;
- ✓ Të ketë dhënë provimin për agjentë përpara Agjencisë dhe
- ✓ Të mos jetë i punësuar në Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalid të Maqedonisë, Fondin e Sigurimeve Shëndetësore të Maqedonisë, Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë, Drejtorinë e të Ardhurave Publike dhe agjencitë për punësim të përkohshëm.

Agjencia përshkruan mënyrën dhe procedurën për dhënien e provimit, për marrjen e statusit të agjentit dhe mënyrën dhe procedurën për regjistrimin e personit në Regjistrin e Agjentëve.

Aplikim për Agjent

Në përputhje me ligjin për financim kapital të sigurimit pensional dhe Ligjin për sigurimin vullnetar pensional me financim kapital, agjentët nuk mund të jenë punonjës në Agjencinë e Punësimit, Drejtorinë e të Ardhurave Publike, Fondin e Sigurimit Shëndetësor dhe Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor.

[FORMULAR PËR PROVIM PËR AGJENT PËR SHOQËRI ANSIONATE](#)